


4 JANAR 2003 – DITA E RËNIES SË KOLONEL TAHIR ZEMAJ

Mal Berisha



**NJË HISTORI E DHIMBSHME QË MA PATI THYER
ZEMRËN**

Ishte viti 2002. Në atë kohë isha punonjës i UNMIK-ut në Kosovë dhe më qëlloni të bëhesha dëshmitar i një bisede që, më pas, rezultoi të ishte si një profeci tragjike.

Nazim Morina, mik i familjes sime, një dashamirës dhe patriot i thjeshtë nga Rahoveci, më merr një ditë në telefon nga Zvicra dhe, pasi më përshëndet, më thotë:

“Zotëri Berisha, të lutem ruhu, sepse kam frikë se do të të vrasin!”

Unë, në fakt, e mora si me shaka dhe i thashë se nuk kisha asnjë lloj merak, e lëre më frikë.

Nazimi, pasi më dha disa shpjegime, më tha:

“Zotëri Berisha, unë e di shumë mirë këtë, por ti mund të vritesh ‘në moh’, sepse mund të të marrin si objektiv, duke të ngatërruar me dikë tjetër.”

Përsëri, me atë skepticizmin tim, i thashë:

“Askush nuk e di fundin e vet, por e di që nuk ka askush ndonjë arsye për ta bërë këtë ndaj meje.”

Atëherë më tha:

“I kam parë fotot e tua të këtyre kohëve të fundit dhe i ngjan shumë një personi që është në shënjestër për t’u vrarë. Ai është kolonel Tahir Zemaj.”

Kolonel Zemaj i kishte mbijetuar dy atentateve deri në atë kohë, ndaj miku im ishte bërë merak se mos pësoja edhe unë ndonjë gjë, thjesht bazuar në ngjashmërinë me atë burrë që nuk e kisha parë kurrë.

Në të vërtetë, për shkak të një traume shëndetësore të asaj kohe, pamja ime kishte ndryshuar shumë dhe, për shkak të mjekrës gjysmë të thinjur, disa tipareve të përafërta dhe moshës thuajse të njëjtte me kolonelin, duhej të kishim një farë ngjashmërie.

SI E PASHË DHE E NJOHA PËR HERË TË PARË DHE TË VETME KOLONELIN TAHIR ZEMAJ PËRPARA GJYKATËS NDËRKOMBËTARE NË PEJË

Për ko incidencë, vetëm pak ditë pas kësaj bisede, pata rastin ta shihja kolonelin në sallën e gjyqit të Gjykatës së Qarkut të Pejës.

Gjykatësja ndërkombëtare, e kishte thirrur për të dëshmuar kolonel Tahir Zemën. Sipas rregullave të gjykatës, ai erdhi, përshëndeti, i dha të gjitha të dhënat, dëshmoi për ato çështje për të cilat u pyet dhe e përfundoi dëshminë e tij.

Gjykatësja, pasi mbylli procesverbalin, i adresoi kolonelit një pyetje që mua më shokoi:

“Kolonel Zemaj, faleminderit që erdhët në gjykatë. Jam e interesuar të di: a nuk patët frikë që erdhët, pasi për ju flitet hapur se ju ndjekin për t’ju vrarë?”

Koloneli iu përgjigj:

“E nderuar zonja gjykatëse! Po më habitni me këtë pyetje!

Unë jam ushtarak. Jam luftëtar dhe patriot dhe shumë herë e kam vënë jetën time në rrezik për Kosovën. Prandaj nuk e di se çfarë është frika. Në rastin konkret, unë e kreuva detyrën time si qytetar i Kosovës sime, për të cilën kam luftuar. E respektova gjykatën dhe dëshmova, jo si i pandehur. Sa i përket sigurisë së jetës sime për ardhjen time këtu, duhet të ndiheni përgjegjëse ju që më keni thirrur.”

Gjykatësja mbeti gojëkyçur.

Pas pak kohe, më 4 janar 2003, ai u vra në mes të Pejës, bashkë me të birin, Enes Zemaj, 22 vjeç, dhe nipin, Hasan Zemaj, 24 vjeç, duke i shkaktuar Kosovës një humbje të madhe, një plagë të rëndë dhe një rekord të turpshëm e të pamërituar në historinë e saj më të re.

Sot e kujtoj me nderim dhe dëshiroj të vendos foton time të asaj kohe përkrah asaj të atij burri, të cilat vërtet kanë njëfarë ngjashmërie. Miku im nga Zvicra mund të kishte pasur të drejtë...!

Sot, në ditën e rënies, se heroit dëshiroj të deklamoj:

I paharruar Kolonel Tahir Zemaj, mbajtës i medaljeve “Hero i Kosovës”, akorduar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, dhe “Nderi i Kombit”, dhënë nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

Nderim të përjetshëm!